



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.958/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada - Gillogjani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Tringa Sfishta nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.958/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga Tringa Sfishta nga Podujeva, Kandidate për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, i datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.958/2021, të paraqitur nga Tringa Sfishta, nga Podujeva, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilin kërkon që të bëhet rinumërimi, i vendotimeve 1808E/02D, 1802X/03R, pasi që ka pasur pritshmëri më të madhe të votave nga rezultati i shpallur nga KQZ-ja, apelit i ka bashkangjitur edhe deklaratat e votuesve të cilët deklarojnë se e kanë votuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Tringa Sfishta, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Xhevdet Maloku kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, të paraqitur me datën 04.11.2021 dhe është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se Apeli i parashtruar nga Tringa Sfishta, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.958/2021 më datën 06.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.